



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

---

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_/\_\_\_/2019

**V E N D I M**

**Nr. 62, Datë 17/05/2019**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 18, datë 28.02.2019, e Shoqatës së Pavarur Mikse “Shpresë për të varfërit” dhe Shoqatës “Integrimi i Romëve të Veriut”, Lezhë, ku pretendohet së pari, diskriminim i komunitetit rom dhe atij egjiptian të këtij qyteti, dhe së dyti, diskriminim i vetë shoqatave ankuese, për mospjesmarrje në takime apo vendimmarrjet e Qendrës Komunitare Multifunkionale Malteser Lezhë, për shkak të “etnisë”, “gjendjes ekonomike” dhe “gjendjes arsimore”, nga ana Bashkisë Lezhë dhe Organizatës Shqiptare të Urdhërit të Maltës, me qendër në Shkodër.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>1</sup>,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjekteve ankuese.**

Sipas shpjegimeve të dhëna në ankesë, rezulton se në muajin nëntor 2017, Organizata Shqiptare e Urdhërit të Maltës në bashkëpunim me Bashkinë Lezhë inaguruan hapjen e Qendrës Komunitare Multifunkionale Malteser Lezhë, qëllimi kryesor, i së cilës, sipas shoqatave ankuese ishte frekuentimi i aktiviteteve dhe shërbimeve që ajo ofronte, nga anëtarët e komunitetit rom dhe atij egjiptian të këtij qyteti. Në ankesë pretendohet se kjo qendër është parashikuar të ofrojë shërbime ditore për parashkollorët, për fëmijët që kanë nevojë për asistencë të diferencuar në mësim, si dhe konsulencë psikologjike dhe juridike për komunitetin rom dhe atij egjiptian.

Shoqatat ankuese theksojnë faktin se pranë kësaj qendre ishte punësuar përmes procedurave të konkurimit, një anëtar i komunitetit egjiptian të qytetit të Lezhës, fakt që ishte përkrahur nga dy shoqatat e sipërpërmendura. Në muajt e parë të funksionimit të kësaj qendre kishte një fluks të

---

<sup>1</sup> Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën KMD.

madh të frekuentimit të saj nga komuniteti rom dhe ai egjiptian i qytetit të Lezhës, por me kalimin e kohës, subjektet ankuese shprehen se kjo qendër i tjetërsoi shërbimet e saja. Tjetërsimi i shërbimeve të kësaj qendre konsiston në faktin, se nga muaji nëntor 2017 e deri në muajin shtator 2018, qendra frekuentohej falas nga fëmijët e moshës 3-6 vjeç, nga ora 07:30 deri në orën 12:30, ndërkohë që në muajin shtator 2018 e në vijim ky shërbim u bë me parapagesë dhe aktualisht frekuentohet vetëm nga fëmijët e parashkollorit të kopështit “Skënderbeg”, Lezhë. Një gjë e tillë solli si pasojë mos frekuentimin e kësaj qendre nga fëmijët e komunitetit rom dhe atij egjiptian, familjet e të cilëve nuk e përballonin dot pagesën e vendosur nga Qendra.

Shoqatat ankuese theksojnë faktin, se tjetërsimi i shërbimeve të ofruara nga kjo qendër, si dhe mos aksesimi i shërbimeve nga të gjitha shtresat e komunitetit, por vetëm nga fëmijët e moshave 6-15 vjeç, solli si pasojë që përfaqësuesi i komunitetit egjiptian, që ishte i punësuar në këtë qendër të japë dorëheqjen nga pozicioni i punës “koordinator”, sepse e pa veten jashtë përfaqësimit të këtij komuniteti.

Në ankesë sqarohet se shoqatat, si dhe komuniteti rom e ai egjiptian janë shumë të indinjuar për faktin se kjo qendër po frekuentohet vetëm nga maxhoranca e qytetit të Lezhës, e si rrjedhojë ndihen të diskriminuar.

Diskriminimi për shkak të gjendjes ekonomike justifikohet me faktin se fëmijët e komunitetit rom dhe atij egjiptian nuk kanë mundësi për të paguar kuotën e vendosur nga Qendra, e si rrjedhim janë të përjashtuar nga frekuentimi i saj. Njëkohësisht, pretendimi për diskriminim për shkak të etnisë mbështetet në faktin e largimit nga puna të punonjësve të komunitetit rom, që fillimisht u punësuan pranë kësaj qendre. Shumica e tyre ishin të punësuar në pozicionet e sanitareve, të cilat tashmë janë zëvendësuar me punonjëse, që i përkasin maxhorancës. Pretendimi për diskriminim për shkak të gjendjes arsimore, mbështetet në faktin se fëmijët që nuk kanë aftësi të mira në të nxënë, shpesh herë nxirren nga Qendra dhe në shumicën e rasteve nuk pranohen në ambientet e saj. Një gjë e tillë ka sjellë shqetësim tek fëmijët, të cilët shpesh e herë kanë kaluar në konflikt verbal me punonjësit e qendrës, që shpeshherë ushtrojnë dhunë fizike apo verbale ndaj tyre.

Subjektet ankuese shprehen se edhe pse Qendra Komunitare Multifunkionale Malteser Lezhë është ngritur për komunitetin rom dhe atë egjiptian të këtij qyteti, kryetarët e shoqatave, që përfaqësojnë këto komunitete apo anëtarë të këtyre komuniteteve, nuk njoftohen për pjesëmarrje në takime të organizuara pranë kësaj qendre dhe si rrjedhim nuk japin mendimin e tyre në vendimmarrjet e saj.

## I. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

- A. Pas analizimit të ankesës nr. 18, datë 28.02.2019, e Shoqatës së Pavarur Mikse “Shpresë për të varfërit” dhe Shoqatës “Integrimi i Romëve të Veriut”, Lezhë, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.
- B. Mbështetur në nenin 33, pika 7<sup>2</sup>, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua Bashkisë Lezhë dhe Organizatës Shqiptare të Urdhërit të Maltës, me shkresën nr. 304/1, datë 07.03.2019, ku kërkohej informacion, si më poshtë vijon:
- Informacion i plotë, lidhur me pretendimet e Shoqatës së Pavarur Mikse “Shpresë për të varfërit” dhe Shoqatës “Integrimi i Romëve të Veriut”, Lezhë;
  - Kopje e Aktit të Krijimit të Qendrës Komunitare Multifunkionale Malteser Lezhë dhe çdo lloj akti tjetër, i cili përcakton qëllimin dhe veprimtarinë e kësaj qendre.
  - Kopje e strukturës organike të Qendrës Komunitare Multifunkionale Malteser Lezhë.
  - Lista e punonjësve të kësaj qendre, ku të evidentohet qartë data e punësimit. Në këtë listë të përcaktohet, se cilët punonjës i përkasin komunitetit rom dhe atij egjiptian.
  - Informacion mbi faktin, nëse është vendosur tarifë për ndjekjen e aktiviteteve të qendrës nga fëmijët parashkollorë. Nëse po, të përcaktohet mbi ç’bazë është vendosur një gjë e tillë, si dhe të dërgohet kopje e aktit administrative, nëpërmjet së cilit është vendosur parapagesa dhe mënyra e kryerjes së saj;
  - Informacion mbi numrin e fëmijëve parashkollorë, që ndjekin këtë qendër. Këtu, të evidentohet numri i fëmijëve romë dhe atyre egjiptianë;
  - Informacion mbi autoritetin që kryen emërimet/lirimet nga detyra në këtë Qendër dhe aktin që e parashikon këtë;
  - Informacion mbi numrin e fëmijëve, që frekuentojnë qendrën dhe kanë vështirësi me nxënien. Sa prej tyre i përkasin komunitetit rom dhe atij egjiptian?
  - Çdo informacion tjetër që ka lidhje me çështjen e parashtruar nga ankuesit.

---

<sup>2</sup> Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon: “Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër”.

1. Në përgjigje të shkresës nr. 304/1, datë 07.03.2019, të Komisionerit, Bashkia Lezhë dërgoi shkresën nr. 2223/1, datë 18.03.2019, nëpërmjet së cilës sqaron se shërbimet që ofrohen në Qendrën Komunitare Multifunkionale Malteser Lezhë janë përcaktuar në Marrëveshjen e Bashkëpunimit nr. 9690/1, datë 18.11.2016, që Bashkia Lezhë ka lidhur me Organizatën e Urdhërit të Maltës, (Malteser). Në këtë kontekst, ky institucion kundërshton pretendimet e palëve ankuese për tjetërsim të shërbimeve, pasi në kushtet e ekzistencës së një marrëveshjeje me shkrim, shërbimet nuk mund të tjetërsohen. Njëkohësisht, Bashkia Lezhë sqaron se në bazë të informacionit të dërguar nga Organizata e Urdhërit Malteser nuk ka ndonjë pagesë për shërbime, të cilat ofrohen falas siç është përcaktuar në marrëveshjen e bashkëpunimit dhe si rrjedhojë nuk mund të ketë diskriminim për shkak të gjendjes ekonomike.

Lidhur me pretendimin e diskriminimit për shkak të etnisë, si dhe lidhur me çështjen e largimit të punonjësve të punësuar fillimisht pranë kësaj qendre, Bashkia Lezhë sqaron se në nenin 7, të Marrëveshjes së Bashkëpunimit parashikohet një menaxhim i Qendrës, për një periudhë 10 vjeçare nga Malteser. Si rrjedhim, të gjithë emërimet dhe largimet kryhen nga kjo organizatë. Bashkia Lezhë sqaron gjithashtu se nuk ka asnjë kusht të marrëveshjes për punësimin e anëtarëve të komunitetit rom apo atij egjiptian, por vetëm mbi bazën e aftësive profesionale. Qendra Komunitare Multifunkionale Malteser nuk është një qendër me fokus punësimin e komunitetit rom dhe komunitetit egjiptian, por një qendër që ofron programe të ndryshme ri-integrimit për komunitetin rom dhe atë egjiptian, si dhe për të gjitha shtresat në nevojë. Bashkia Lezhë thekson faktin se Qendra Komunitare Multifunkionale Malteser nuk është e vetmja qendër komunitare, ku komuniteti rom dhe ai egjiptian marrin shërbime, pasi në Lezhë janë ngritur 5 (pesë) Qendra Komunitare, ku përfituesit më të shumtë janë ata të komunitetit rom dhe atij egjiptian, si kategori vunerabël. Për mbështetjen dhe punësimin e individëve, që i përkasin këtyre komuniteteve, Bashkia Lezhë ka në zbatim disa projekte, nëpërmjet së cilave ofron mundësi punësimi. Nëpërmjet programit të ri-integrimit të familjeve të kthyer nga emigracioni me financimin e organizatës “Terre des homes”, Bashkia Lezhë ka mbështetur 30 familje me mini biznese dhe me ndihmë direkte të komunitetit rom dhe atij egjiptian dhe aktualisht vazhdon të trajtojë familje, nëpërmjet kursit të sipërmarrjes për të punësuar edhe 12 familje të tjera. Janë liçencuar gjithashtu edhe 2 biznese familjare. Gjithashtu nëpërmjet projektit “Askush të mos mbetet pas” duke synuar rritjen e përfshirjes sociale të romëve dhe egjiptianëve, mbështetjen e arsimit cilësor të fëmijëve, që i përkasin këtyre komuniteteve, si dhe duke ofruar njëkohësisht shërbime sociale të familjeve të tyre, përfshirë lehtësimin për formimin profesional (VET), punësimin, zhvillimin e kapaciteve individuale. Nëpërmjet këtij projekti, Bashkia Lezhë ka mbështetur 14 familje me ndërhyrje emergjente, 25 familje me skema gjenerimi të ardhurash, një familje ka liçencuar biznesin dhe aktualisht 3 familje të tjera janë në proces mbështetjeje.

Lidhur me pretendimin e diskriminimit për shkak të gjendjes arsimore të fëmijëve, Bashkia Lezhë sqaron se ky pretendim nuk është i vërtetë, sepse nuk ka patur asnjë rast keqtrajtimi apo

ankese kundrejt punonjësve të Qendrës dhe shërbimet që ofrohen janë lehtësuese dhe ndihmuese, për fëmijët që kanë vështirësi në mësim.

Lidhur me pretendimin se kryetarët e shoqatave rome dhe shoqatave egjiptiane, si dhe anëtarët e këtyre komuniteteve nuk njoftohen për pjesëmarrje, Bashkia Lezhë sqaron se ky pretendim nuk është i vërtetë sepse shumica e frekuentuesve dhe përfituesve të qendrës janë nga komuniteti rom dhe ai egjiptian.

Lidhur me çështjen e parë, për të cilën kërkohet informacion nga KMD, Bashkia Lezhë informon se pretendimet e dy shoqatave ankuese nuk janë të vërteta dhe ekziston dyshimi se kjo ankesë është hakmarrje personale nga ana e kryetarit të shoqatës “Integrimi i romëve të veriut”, sepse pranë kësaj qendre ka qenë e punësuar si sanitare, bashkëshortja e kryetarit të kësaj shoqate. Bashkia Lezhë thekson faktin se ka marrë parasysh gjithmonë ankesat dhe mendimet e kryetarëve të shoqatave apo anëtarëve të komunitetit rom dhe atij egjiptian që në fokus kanë patur mbrojtjen e të drejtave të këtij komuniteti, por jo ankesa me karakter përfitimi personal nga kryetarët e shoqatave.

Bashkëlidhur shkresës nr. 2223/1, datë 18.03.2019, Bashkia Lezhë dërgoi kopje të Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë Lezhë dhe Organizatës Shqiptare të Urdhërit të Maltës, Malteser nr. 9690/1, datë 18.11.2016, shërbimeve që ofron Qendra Malteser, të cilat sipas marrëveshjes së bashkëpunimit ofrohen falas, informacion mbi numrin e fëmijëve parashkollorë që ndjekin qendrën, si dhe evidencat e 4 mujorit të fundit të vitit 2018, mbi frekuentuesit e kësaj qendre.

Autoriteti që kryen emërimet /lirimet nga puna është Organizata Shqiptare e Urdhërit të Maltës, sipas nenit 7 të Marrëveshjes së Bashkëpunimit, ku parashikohet menaxhimi i kësaj qendre për një periudhë 10 vjeçare nga Malteser.

Qëllimi i hapjes së kësaj qendre ka qenë dhënia e shërbimeve të tilla si:

- Programi pas shkolle për fëmijët 7-15 vjeç;
- Aktivitete sportive me fëmijët e qendrës;
- Aktivitete sportive me komunitetin;
- Kurse kundër analfabetizmit;
- Edukim shëndetësor për komunitetin.

Programi pas shkolle (afterschool) ndiqet nga dy grupe fëmijësh. Në grupin e parë, që përbëhet nga fëmijë që i përkasin nga klasave I-IV bëjnë pjesë 30 fëmijë, nga të cilët 27 fëmijë i përkasin komunitetit rom dhe atij egjiptian dhe 3 fëmijë i përkasin maxhorancës. Në grupin e dytë, që përbëhet nga fëmijë që i përkasin klasave V-IX bëjnë pjesë 37 fëmijë frekuentues, nga të cilët 32 fëmijë i përkasin komunitetit rom dhe atij egjiptian dhe 5 fëmijë i përkasin familjeve të maxhorancës.

Nga monitorimet e kryera nga ana e Bashkisë Lezhë nuk është vënë re në asnjë moment, diskriminimi i fëmijëve romë dhe egjiptianë, pasi Qendra është hapur për të qenë sa më afër këtyre komuniteteve, duke dhënë shërbime që të lehtësojnë sa më shumë jetesën për anëtarët e tyre.

2. Në përgjigje të shkresës nr. 304/1, datë 07.03.2019, të Komisionerit, Organizata Shqiptare e Urdhërit të Maltës dërgoi shkresën nr. 445, datë 21.03.2019, nëpërmjet së cilës sqaron se Qendra Multifunkionale Malteser në Lezhë u ndërtua dhe funksionon në bazë të Marrëveshjes së bashkëpunimit nr. 9690, datë 18.11.2016, ndërmjet Bashkisë Lezhë dhe Organizatës Shqiptare të Urdhërit të Maltës, e miratuar me Vendimin nr. 217, datë 04.12.2017, të Këshillit Bashkiak. Organizata Shqiptare e Urdhërit të Maltës (OSHUM)/Malteser në bashkëpunim me Bashkinë e Lezhës e hapën këtë Qendër, me qëllim ofrimin e disa shërbimeve të munguara ose të ofruara jo në nivelin e duhur, për komunitetet romë dhe egjiptiane, por jo vetëm për këto komunitete. Të gjitha shërbimet e ofruara në këtë qendër, por edhe shërbime të tjera që ofrohen në komunitet janë të aksesueshme nga të gjithë anëtarët e komuniteteve dhe shtresave në nevojë, në qytetin e Lezhës. Kjo është kryer edhe me qëllim mos segregimin e komunitetit rom dhe atij egjiptian, si dhe dhënien e kontributit të kësaj organizate në integrimin e këtyre dy komuniteteve.

Në shkresë theksohet fakti se për fëmijët e moshës 3-6 vjeç u ofrua shërbimi i një qendre të hapur ditore nga ora 7:30-12.30, shërbim i cili deri në muajin shtator 2018 u frekuentua nga 11 fëmijë, nga të cilët 9, i përkisnin komunitetit rom dhe atij egjiptian. Në shtator 2018, në bashkëpunim me Bashkinë Lezhë, pas vlerësimit të këtij shërbimi si jo efektiv, në raport me mundësitë/kapacitetet më të mëdha që ofron Qendra, si dhe duke marrë parasysh nevojat në rritje të bashkisë për arsimin parashkollor, u vendos që shërbimi ditor të zhvillohej e të ngrihej në nivelin e një kopështi të standardizuar parashkollor (për moshën 5-6 vjeç), me programe të miratuara nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Në këtë mënyrë, kjo Qendër ka kontribuar në uljen e mbingarkesës që kanë kopështet publike, duke i kushtuar më tepër hapësirë grupmohës 3-4 vjeç. Për këtë arsye nga OSHUM u punësua edhe një profesionist i fushës, u zhvilluan sipas standardeve të kërkuara mjetet didaktike, si dhe për të qenë më afër me komunitetin në nevojë, oraret u bënë më të gjata (7:30-14:00). Për ditën e shtunë gjithashtu u vendos të ofrohej program ekstrakurrikular për të gjithë fëmijët e kopështit me të njëjtin orar si në ditët e javës.

Ky shërbim, ashtu si edhe më parë ofrohet falas për komunitetet romë dhe egjiptiane, si dhe për komunitetet e tjera në nevojë, në referencë të “Marrëveshjes me prindërit” (marrëveshje tip). Kategoritë përfituese të të gjitha shërbimeve, sigurisht pa asnjë pagesë, janë si më poshtë: (1) përfituesit e ndihmës ekonomike; (2) komuniteti rom dhe ai egjiptian; (3) persona me aftësi të

kufizuara; (4) fëmijë kur njëri nga familjarët e tyre është paraplegjik ose tetraplegjik; (5) fëmijë që kanë statusin e jetimit.

Për të mbrojtur komunitetet në nevojë, si dhe për të kontribuar në gjithëpërfshirje, OSHUM<sup>3</sup> vendosi të pilotojë një tarifë solidariteti për fëmijët pjesëmarrës në këtë kopësht parashkollor, që nuk i përkasin grupeve në nevojë, gjë për të cilën është lidhur edhe “Marrëveshje me prindërit”.

Aktualisht, kopështi frekuentohet nga 9 fëmijë, nga të cilët 1 fëmijë i përket komunitetit rom, 6 fëmijë i përkasin komuniteteve të tjera të mbrojtura dhe 2 fëmijë të tjerë, të cilët duhet të paguanin. Në bashkëpunim me Bashkinë Lezhë, u vendos që kjo tarifë do të mbulohej nga Bashkia Lezhë, në formën e aktiviteteve ekstrakurrikulare për fëmijët e kopështit. Si rezultat, nuk është mbledhur asnjë tarifë nga prindërit.

Në programin “afterschool” ose të “asistencës së diferencuar në mësim” janë të regjistruar 67 fëmijë, nga të cilët 59 fëmijë i përkasin komunitetit rom dhe atij egjiptian dhe 8 fëmijë i përkasin shtresave të tjera në nevojë.

Në kursin aktual kundër analfabetizmit janë regjistruar 11 persona madhorë, nga të cilët 9 të tillë, i përkasin komunitetit rom dhe atij egjiptian. Bashkëlidhur shkresës nr. 445, datë 21.03.2019, mbështur në kërkesën e KMD-së, Organizata Shqiptare e Urdhërit të Maltës dërgoi edhe listat e përfituesve.

Në shkresën e sipërpërmendur theksohet fakti se në këtë Qendër, nuk është kërkuar pagesë nëpërmjet ndonje tarifë për komunitetin rom, atij egjiptian apo komunitetet e tjera në nevojë. Në këtë kontekst, OSHUM kundërshton pretendimet e dy shoqatave ankuese për diskriminim për shkak të gjendjes ekonomike.

Në lidhje me pretendimet e dy shoqatave ankuese se *“tjetërsimi i shërbimeve të ofruara nga kjo qendër, si dhe mos aksesimi i shërbimeve nga të gjitha shtresat e komunitetit, por vetëm nga fëmijët e moshave 6-15 vjeç, solli si pasojë që përfaqësuesi egjiptian, që ishte punësuar në këtë qendër të japë dorëheqjen nga pozicioni i punës “koordinator”, sepse e pa veten jashtë përfaqësimit të këtij komuniteti”,* Organizata Shqiptare e Urdhërit të Maltës sqaron fillimisht se nuk ka asnjë tjetërsim shërbimesh, por vetëm një zhvillim cilësor të tij, në përputhje me nevojat e komunitetit, e konsultuar kjo edhe me Bashkinë Lezhë, si dhe në mbështetje të detyrimeve që kanë ardhur nga Marrëveshja e Bashkëpunimit me këtë institucion. Kufizimet në mosha janë si rezultat i programeve mësimore edukative të përcaktuara nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si dhe kapaciteteve të programeve të qendrës. Për shembull Qendra nuk ka ofruar asnjëherë shërbime specifike ditore për fëmijët e moshës 0-3 vjeç, ose për moshën e tretë, por kjo nuk mund të konsiderohet si diskriminim. OSHUM punësoi një koordinator për qendrën, i cili i përkiste komunitetit egjiptian, meqë ai plotësonte kërkesat bazë të edukimit formal dhe u

---

<sup>3</sup> Organizata Shqiptare e Urdhërit të Maltës;

kualifikua vetëm prej prioritetit etnik, të vënë në kriteret shtesë. Nga komunitetet rome/egjiptiane, ai ishte i vetmi person që aplikoi, pavarësisht të njëjtës ofertë për të gjitha pozicionet e tjera. Zhvillimet e programeve nga Qendra e hapur në kopësht u bënë në shtator 2018 dhe jo gjatë kohës që ish-koordinatori ka qenë i punësuar. Këto programe u realizuan 2 (dy) muaj, pasi koordinatori kishte dhënë dorëheqjen dhe disa javë më vonë pasi përfundimisht kishte mbyllur kontratën e punës me OSHUM. Në këtë kontekst, OSHUM nuk konstaton asnjë arsye që dorëheqja e tij, të ketë lidhje me ndryshimet evoluese të shërbimeve të qendrës. Njëkohësisht, Malteser thekson faktin se gjatë komunikimit në vijim me ish-punonjësin e dorëhequr, nuk jepet asnjë arsye e lidhur me pretendimet e shoqatave në ankesë, përkundrazi ai shpreh kënaqësinë për punën e kryer në bashkëpunim me stafin e OSHUM. Bashkëlidhur shkresës, OSHUM ka dërguar kopje të korrespondencës me ish-punonjësin e dorëhequr. Ndër të tjera, Malteser shprehet se në këtë Qendër u punësua një coordinator, që i përkiste komunitetit egjiptian, por jo me një përfaqësues të komunitetit.

Në lidhje me pretendimin e dy shoqatave lezhjane për diskriminim për shkak të etnisë, që mbështetet në faktin e largimit nga puna të komunitetit rom, që ishte punësuar në pozicionet e sanitareve, OSHUM sqaron se personeli i qendrës i paguar nga OSHUM, përbëhet nga: 1 (një) Koordinator (aktualisht jurist), 2 (dy) punonjëse sociale (master në punë sociale/psikologji organizative), 1 (një) edukatore (cikël i ulët parashkollor), 1 (një) mësuese për kurset e analfabetizimit (mësuese gjuhe në sistemin shtetëror në Lezhë, aktualisht me kontratë shërbimi me OSHUM). Asnjë nga personat e sipërpërmendur nuk i përket komunitetit rom apo atij egjiptian. Nga komuniteti egjiptian kishte vetëm një aplikim, që plotësonte kriteret bazë të kualifikimit, i cili u emërua Koordinator dhe në vijim dha dorëheqjen. Bashkëlidhur shkresës nr. 445, datë 21.03.2019, së Organizatës Shqiptare të Urdhërit të Maltës është dërguar edhe lista e personave të punësuar në Qendër, të cilët janë përgjegjës për aktivitetin e përditshëm të saj, si dhe datat e emërimit dhe largimit nga puna për secilin punonjës.

Në shkresë sqarohet se personeli i Qendrës mbështetet nga Zyra Qendrore me menaxher/supervisor e financiar rajonal, që kryejnë edhe detyra të tjera në programe të ndryshme. Në qendër punon edhe personel mbështetës (psikolog, infermier, mjek, edukator etj.), i cili është në marrëdhënie kontraktore apo vullnetare me qendrën. Autoriteti përgjegjës që kryen emërimet/lirimet nga detyra në këtë qendër, sipas marrëveshjes së bashkëpunimit me Bashkinë Lezhë është OSHUM.

OSHUM thekson faktin se Bashkia Lezhë ka qenë e mirëpritur të kontribuojë me staf shtesë në çdo nivel, si atë teknik apo mbështetës, duke ndihmuar në plotësimin e mangësive, apo në rritjen sasiore ose cilësore të aktiviteteve të qendrës. Në këtë kontekst, Bashkia Lezhë emëroi me kontrata të përkohëshme (2) dy punonjëse mbështetëse – sanitare, të cilat me përfundimin e kontratës së punës, nuk vazhduan më të punonin aty. Bashkia Lezhë ka qenë punëmarrës për këto dy punonjëse, të cilat i përkisnin komunitetit rom dhe atij egjiptian.



Në lidhje me pretendimin për diskriminim për shkak të gjendjes arsimore, ku pretendohet se fëmijët romë dhe ata egjiptianë shpeshherë nxirren jashtë nga qendra, apo nuk pranohen në ambientet e saj, si dhe punonjësit e Qendrës ushtrojnë dhunë fizike apo verbale ndaj tyre, OSHUM sqaron se kjo organizatë nuk është në dijeni të rasteve, kur fëmijët e regjistruar në qendër, përfitues të shërbimeve të saj, të kenë patur vështirësi aksesit në këtë qendër apo në shërbimet e saj dhe aq më tepër që të jetë ushtuar dhunë fizike dhe verbale ndaj tyre, apo ata të jenë larguar nga qendra. OSHUM thekson faktin se kjo është hera e parë që vihen në dijeni të këtij fakti dhe se nëse këto janë të vërteta, kjo organizatë disponon mekanizma ankimi për raste të tilla. OSHUM shpreh gadishmërinë, që pasi të ketë marrë informacionin e duhur, specifik, lidhur me këto raste, të fillojnë procedurat për verifikimin e tyre dhe marrjen e masave të duhura.

Organizata Shqiptare e Urdhërit të Maltës sqaron se i gjithë personeli i qendrës i emëruar nga OSHUM, është profesionist në fushat përkatëse dhe ky staf është i mirë informuar mbi të drejtat e fëmijëve. Secili prej këtyre punonjësve ka pranuar dhe ka nënshkruar së bashku me kontratën e punës, një Kod Sjelljeje me fëmijët dhe Politikën e ruajtjes së Fëmijëve, që është pjesë e Kodit të Sjelljes së OSHUM – Malteser Shqiptar e Malteser Ndërkombëtar. Bashkëlidhur shkresës kjo organizatë ka përcjellë edhe një përkrahje të shkurtër të aktivitetit të OSHUM në Shqipëri.

Ndër të tjera, Organizata Shqiptare e Urdhërit të Maltës thekson faktin se ankesa e dy shoqatave lezhjane është e motivuar nga interesa të tjera, private, të tyre e jo nga interesat e komunitetit rom dhe atij egjiptian në përgjithësi. OSHUM e bën me dije Komisionerin se Koordinatori i dorëhequr është një nga bashkëdrejtuesit e njëres prej shoqatave ankuese dhe njëra nga punonjëset e personelit mbështetës të Qendrës, që ka qenë kontraktuar nga Bashkia Lezhë dhe që aktualisht nuk punon pranë Qendrës, pasi ka përfunduar afati i kontratës së saj të punës, është bashkëshortja e drejtuesit të shoqatës ankuese.

## **I. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

### **A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë.**

Mbështetur në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit administrativ të ankesës nr. 18, datë 28.02.2019, të Shoqatës së Pavarur Mikse “Shpresë për të varfërit” dhe Shoqatës “Integrimi i Romëve të Veriut”, Lezhë, rezulton se Bashkia Lezhë, e përfaqësuar nga kryetari i saj, Z. F. F. dhe Organizata Shqiptare e Urdhërit të Maltës<sup>4</sup>, përfaqësuar nga Drejtori i saj Ekzekutiv, Z. M.

---

<sup>4</sup> Referuar [www.malteser.al](http://www.malteser.al), Organizata Shqiptare e Urdhërit të Maltës ose Malteser Shqipëri ose është një OJF shqiptare, me qendër në Shkodër, e cila është themeluar nga Malteser Hilfsdienst në Gjermani dhe vepron në Shqipëri që prej vitit 1995. Organizata është e regjistruar si person juridik nëpërmjet vendimit nr. 231, datë 28.06.1999, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Aktiviteti i saj fokusohet në fushën mjekësore, sociale dhe mbrojtje civile.

M., në vitin 2016, kanë lidhur Marrëveshjen e Bashkëpunimit nr. 9690/1, datë 18.11.2016. Kjo marrëveshje bashkëpunimi është miratuar me Vendimin nr. 217, datë 04.12.2017, e Këshillit Bashkiak Lezhë, i cili ka kryer në fuqi sipas përcaktimeve të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor të institucionit të Prefektit të Qarkut Lezhë.

- Lidhur me pretendimin e dy shoqatave ankuese, se Qendra Komunitare Multifunkionale Malteser është ngritur për komunitetin rom dhe komunitetin egjiptian të qytetit të Lezhës dhe se pavarësisht kësaj, numri i fëmijëve të këtyre komuniteteve, që frekuentojnë këtë qendër, është më i vogël, se numri i fëmijëve të maxhorancës, si pasojë e vendosjes nga ana e Bashkisë Lezhë dhe Organizatës Shqiptare të Urdhërit të Maltës, së një tarife, që ata duhet të paguajnë për të marrë shërbime në të këtë Qendër, Komisioneri vlerësoi si më poshtë:

Në nenin 1, të Marrëveshjes Bashkëpunimit nr. 9690/1, datë 18.11.2016, ndërmjet Bashkisë Lezhë dhe Organizatës Shqiptare të Urdhërit të Maltës përcaktohet se: “.....Në bazë të kësaj marrëveshjeje është ndërtimi dhe vënia në funksion e një Qendre Multidisiplinare pranë komunitetit rom e egjiptian dhe ofrimi i shërbimeve pranë kësaj qendre për familjet në vështirësi social-ekonomike”. Në nenin 3, të kësaj marrëveshjeje parashikohet: “Kjo marrëveshje ka për qëllim rregullimin e marrëdhënieve institucionale midis Bashkisë Lezhë dhe Malteser në zbatimin e programit të bashkëpunimit me qëllim ngritjen dhe funksionimin e një qendre multidisiplinare social-mjekësore në shërbim të komunitetit rom, atij egjiptian dhe shtresave të tjera në nevojë.” Edhe në nenin 4 të kësaj marrëveshjeje parashikohet se Malteser merr përsipër si angazhim të saj, financimin dhe ngritjen e Qendrës Multidisiplinare sociale/shëndetësore në shërbim të komunitetit rom, atij egjiptian dhe shtresave të tjera në nevojë.

Referuar përmbajtjes së neneve të sipërpërmendura të kësaj marrëveshjeje rezulton se fokusi i saj nuk ka qenë vetëm komuniteti rom dhe komuniteti egjiptian i qytetit të Lezhës, por të gjitha shtresat e tjera në nevojë, fëmijët e të cilëve do të përfitonin shërbime shëndetësore, edukative, integruese dhe kulturore, nga kjo qendër. Këtu, duhet theksuar fakti se edhe fëmijë të tjerë të maxhorancës, që nuk i përkasin shtresave në nevojë, janë pjesëmarrës në aktivitetet e kësaj qendre, pavarësisht se në numër më të vogël. Sikurse theksohet në informacionin e dërguar nga Malteser, një gjë e tillë është menduar dhe është realizuar, sidomos për të shmangur segregimin e fëmijëve që i përkasin komuniteteve rome dhe egjiptiane, pra për të mos i veçuar ata në një qendër komunitare vetëm për ta, si dhe për t’i integruar ata me fëmijët e tjerë.

Kategoritë përfituese të të gjitha shërbimeve në këtë Qendër, janë si më poshtë: (1) përfituesit e ndihmës ekonomike; (2) komuniteti rom dhe komuniteti egjiptian; (3) persona me aftësi të

kufizuara; (4) fëmijë kur njëri nga familjarët e tyre është paraplegjik ose tetraplegjik; (5) fëmijë që kanë statusin e jetimit<sup>5</sup>.

Referuar statistikave të përcjella nga Bashkia Shkodër dhe Organizata Organizata Shqiptare e Urdhërit të Maltës rezulton se pranë Qendrës Komunitare Multifunkionale Malteser funksionojnë:

1. Kopështi/parashkollor, që frekuentohet nga 9 fëmijë, nga të cilët 1 fëmijë i përket komunitetit rom, 6 fëmijë i përkasin komuniteteve të tjera të mbrojtura dhe 2 fëmijë të tjerë, të maxhorancës;
2. Programi “afterschool” ose i “asistencës së diferencuar në mësim”, ku janë të regjistruar 67 fëmijë, nga të cilët 59 fëmijë i përkasin komunitetit rom dhe atij egjiptian dhe 8 fëmijë i përkasin shtresave të tjera në nevojë;
3. Kursi kundër analfabetizmit, ku janë regjistruar 11 persona madhorë, nga të cilët 9, i përkasin komuniteteve rom dhe egjiptiane.

Për sa më sipër, konstatohet dominanca e fëmijëve apo përfaqësuesve të komunitetit rom dhe komunitetit egjiptian, në programin “afterschool” dhe në kursin kundër analfabetizmit. Ndërkohë që, në kopësht ose parashkollor, fëmijët e shtresave të tjera në nevojë, përbëjnë numrin më të madh.

Për fëmijët e komunitetit rom dhe komunitetit egjiptian, sikurse dhe për fëmijët e shtresave në nevojë nuk aplikohet asnjë tarifë nga ana e Qendrës Komunitare, për pjesëmarrje në aktivitetet apo programet e saj. Një fakt i tillë rezulton edhe nga Marrëveshjet tip me prindër që Organizata Shqiptare e Urdhërit të Maltës (OSHUM) ka hartuar për t’u nënshkruar nga prindërit e secilit fëmijë.

Sikurse është përmendur në shkresë, OSHUM vendosi të pilotojë një tarifë solidariteti për fëmijët pjesëmarrës në këtë kopësht parashkollor, që nuk i përkasin grupeve në nevojë, fakt që rezulton të jetë e shënuar edhe në “Marrëveshjen tip me prindërit”. Por, pavarësisht kësaj, në bashkëpunim me Bashkinë Lezhë, u vendos që kjo tarifë do të mbulohej nga ky institucion, në formën e aktiviteteve ekstrakurrikulare për fëmijët e kopështit. Si rezultat, nuk është mbledhur asnjë tarifë nga prindërit. Sikurse vihet re nga statistikat e mësipërme, numri i fëmijëve që i përkasin maxhorancës (jo shtresave në nevojë) është 2 fëmijë, të cilët marrin pjesë vetëm në grupin e kopështit apo parashkollorit. Shpenzimet e parashkollorit për këta dy fëmijë mbulohen nga Bashkia Lezhë. Në këto kushte, rezulton se fëmijët që përfitojnë nga programet e ofruara nga Qendra Multifunkionale nuk paguajnë asnjë tarifë dhe shërbimet ndaj tyre ofrohen falas.

Sa më sipër, Komisioneri konstaton se numri i fëmijëve/përfaqësuesve të komunitetit rom dhe atij egjiptian, që përfitojnë nga shërbimet e Qendrës Komunitare Multifunkionale është i

---

<sup>5</sup> Referuar Formatiti tip, të Marrëveshjes me Prindërit, për kopështin parashkollor për grupmoshën 5-6 vjeç.

konsiderueshëm dhe aspak në ulje, sikurse pretendohet nga shoqatat ankuese, si dhe ndaj tyre nuk aplikohet asnjë tarifë, që ka lidhje me përfitimin e shërbimeve nga kjo qendër.

- Lidhur me pretendimin e shoqatave ankuese se në këtë Qendër janë tjetërsuar shërbimet e ofruara për komunitetin rom dhe atij egjiptian, Komisioneri iu referua parashikimeve të Marrëveshjes se Bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë Lezhë dhe Organizatës Shqiptare e Urdhërit të Maltës, ku parashikohen shprehimisht rolet dhe përgjegjësitë e palëve. Sipas kësaj marrëveshjeje, Organizata ka veçanërisht përgjegjësi lidhur me ofrimin e programeve edukative për fëmijët apo përfaqësuesit e rritur/madhore të komunitetit rom dhe atij egjiptian, Bashkia Lezhë merr përsipër një rol të një niveli tjetër, i cili konsiston në detyra të karakterit bashkëpunues, organizativ, infrastrukturor etj., pra që nuk lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me çështjen e ofrimit të programeve edukative. Por gjithsesi, ky institucion merr dijeni nëpërmjet raportimeve 3-mujore të Organizatës Shqiptare e Urdhërit të Maltës, mbi çdo veprimtari të kryer nga Qendra Komunitare Multifunkionale Malteser.

Referuar marrëveshjes në fjalë, disa prej përgjegjësive dhe angazhimeve të Organizatës Shqiptare të Urdhërit të Maltës, parashikohen shprehimisht në nenin IV, si vijojnë:

*“2.1 Financimin dhe ngritjen e Qendrës Multidisiplinare sociale/shëndetësore në shërbim të komunitetit Rom, Egjiptian dhe shtresave të tjera në nevojë.*

.....

*2.9 Të ofrojë shërbime edukative për fëmijët romë dhe egjiptianë, pas orarit të shkollës dhe asistencë për përgatitjen në shkollë.*

*2.12. Të organizojë kurse kundër analfabetizmit për anëtarët e komunitetit Rom dhe egjiptian, të cilët nuk mund të frekuentojnë edukimin e detyrueshëm publik.”*

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se Organizata Shqiptare e Urdhërit të Maltës ka patur si shërbime të detyrueshme në bazë të marrëveshjes *“ofrimin e shërbimeve edukative për fëmijët romë dhe egjiptianë, pas orarit të shkollës dhe asistencë për përgatitjen në shkollë” si dhe “organizimin e kurseve kundër analfabetizmit për anëtarët e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane, të cilët nuk mund të frekuentojnë edukimin e detyrueshëm publik”*. Nga informacioni i dërguar nga Organizata dhe Bashkia Lezhë rezulton se pranë Qendrës Komunitare Multifunkionale Malteser funksionon (1) programi për parashkollorë, (2) programi “after school” dhe (3) kursi kundër analfabetizmit.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se Organizata ka vepruar në përputhje me detyrimet dhe përgjegjësitë e saj, të parashikuara në Marrëveshjen e Bashkëpunimit. Në këtë kontekst, Organizata dhe Bashkia Lezhë nuk i ka ekspozuar fëmijët apo përfaqësuesit e komunitetit rom

dhe atij egjiptian para një trajtimi të pabarabartë, të disfavorshëm e të padrejtë, në krahasim me fëmijët apo përfaqësuesit e shtresave të tjera në nevojë, apo ata të maxhorancës.

- Lidhur me pretendimin e shoqatave ankuese, se përfaqësuesi egjiptian, që punonte në pozicionin e koordinatorit pranë Qendrës Komunitare Multifunkzionale Malteser u dorëhoq pas tjetërsimit të shërbimeve në qendër, Komisioneri gjykon se ky pretendim është i pambështetur në fakte dhe prova konkrete.

Sikurse rezulton nga Marrëveshja e Bashkëpunimit, Qendra Komunitare do të menaxhohet për një periudhë 10 vjeçare nga Organizata Shqiptare e Urdhërit të Maltës. Në këto kushte, emërimet dhe lirimet nga detyra të personelit të Qendrës Komunitare, kryhen nga kjo organizatë. Bashkia Lezhë, sikurse konstatohet nga informacioni i dërguar nga Malteser, ka kryer punësime me kontrata me afat të caktuar, të disa punonjësve, për të mbështetur punën në këtë Qendër. Këta punonjës të emëruar nga Bashkia Lezhë nuk janë pjesë e organikës së Qendrës. Koordinatorin e Qendrës Komunitare Multifunkzionale Malteser është pozicioni i përcaktuar në organikën e kësaj qendre. Pra, emërimi i tij është kryer nga Organizata Shqiptare e Urdhërit të Maltës. Nga korrespondenca elektronike e ish-koordinatorit me Organizatën Shqiptare të Urdhërit të Maltës, rezulton se akti i dorëheqjes së tij, është i vullnetshëm dhe i pakushtëzuar nga faktet e përmendura në argumentet e shoqatave ankuese.

Në Marrëveshjen e Bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë Lezhë dhe Organizatës Shqiptare të Urdhërit të Maltës, nuk ekziston asnjë përcaktim për palët që të punësojnë detyrimisht përfaqësues të komunitetit rom dhe atij egjiptian në stafin e Qendrës Komunitare Multifunkzionale Malteser. Përfaqësuesit e këtyre komuniteteve kanë të drejtë, sikurse edhe përfaqësuesit e shtresave të tjera në nevojë, apo edhe përfaqësuesve të maxhorancës, që të konkurojnë për pozicionet e shpallura vakante pranë kësaj Qendre.

Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se Organizata Shqiptare të Urdhërit të Maltës dhe Bashkia Lezhë nuk i ka ekspozuar përfaqësuesit e komunitetit rom dhe atij egjiptian, para një trajtimi të pabarabartë, të disfavorshëm e të padrejtë, lidhur me të drejtën e tyre për punësim pranë kësaj Qendre, në krahasim me përfaqësuesit e shtresave të tjera në nevojë apo ata të maxhorancës.

- Lidhur me pretendimin e shoqatave ankuese, se ato nuk janë përfshirë në takime dhe vendimarrje të Qendrës Komunitare Multifunkzionale Malteser, Komisioneri sërish i është referuar Marrëveshjes së Bashkëpunimit së lidhur ndërmjet Bashkisë Lezhë dhe Organizatës Shqiptare të Urdhërit të Maltës.

Sikurse u përmend edhe më sipër, në këtë Marrëveshje parashikohen hollësisht përgjegjësitë dhe detyrat e palëve. Në nenin IV, të Marrëveshjes parashikohen angazhimet e Organizatës Shqiptare të Urdhërit të Maltës, disa prej të cilave, përcaktojnë edhe partnerët në bashkëpunim dhe vendimarrje. Pika 2.5 e këtij neni parashikon: *“Të bashkërendojë e koordinojë me Bashkinë*

*Lezhë dhe institucionet e saj të varësisë, planifikimin dhe organizimin e aktiviteteve të përbashkëta në kuadër të zbatimit të kësaj marrëveshjeje, me qëllim ofrimin e shërbimeve sociale, shëndetësore, edukative, integruese dhe kulturore në ambientet e Qendrës.” Pika 2.7, e nenit IV “Angazhimet e Malteser” parashikon gjithashtu: “Të bashkëpunojë me Bashkinë Lezhë, Ministrinë e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë dhe partnerët vendorë për zbatimin të Planit Vendor të Veprimit për mbrojtjen dhe mbështetjen e fëmijëve në situatë rruge.”*

Në pjesën e Marrëveshjes së Bashkëpunimit, ku parashikohen rolet dhe përgjegjësitë e Bashkisë Lezhë, në pikën 2.1, të saj, përcaktohet: *“Të bashkëpunojë me Malteser në veprimtaritë që lidhen me funksionimin e Qendrës pranë komunitetit rom dhe egjiptian”*. Pika 2.3, mbi rolin e Bashkisë Lezhë, parashikon: *“Të koordinojë dhe bashkëpunojë me Malteser, si dhe me partnerët vendorë publikë e private, për zbatimin e Planit vendor të veprimit për mbrojtjen dhe mbështetjen e fëmijëve në situatë rruge”*. Pika 2.4 parashikon *“Të nxisë dhe organizojë takime e tryeza koordinimi mes Malteser, DAR dhe drejtorive të shkollave e kopështeve të identifikuar për përfshirjen e fëmijëve romë dhe egjiptianë në sistemin parashkollor dhe shkollor”*.

Sikurse vihet re, Marrëveshja e Bashkëpunimit i ka mirëpërcaktuar partnerët e bashkëpunëtorët, që duhet të koordinohen ndërmjet njëri tjetrit për mirëfunksionimin e Qendrës Komunitare e Multifunkionale Malteser. Marrëveshja e Bashkëpunimit është një akt, ku shprehet vullneti i dy ose më shumë palëve, duke marrë përsipër të drejta dhe detyrimet përkatëse, për të siguruar ecurinë dhe mirëfunksionimin e projektit, në të cilin janë angazhuar.

Në këto kushte, Komisioneri gjykon se në referencë të nenit 7, pika 1, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, dy shoqatat ankuese nuk i janë nënshtruar një trajtimi të padrejtë, disfavorizues e të barabartë nga ana e Bashkisë Lezhë dhe Organizatës Shqiptare të Urdhërit të Maltës.

Por, pavarësisht sa më sipër, Komisioneri do ta vlerësonte faktin, nëse Bashkia Lezhë dhe Organizata Shqiptare e Urdhërit të Maltës, për çështje apo aktivitete të caktuara, që janë të lidhura specifikisht me komunitetin rom dhe atë egjiptian, të merrnin në konsideratë edhe mendimin dhe gjykimin e shoqatave, që përfaqësojnë këto komunitete. Kjo do të ndikonte pozitivisht në mbarëvajtjen e Qendrës Komunitare Multifunkionale Malteser.

- Lidhur me pretendimet e 2 (dy) shoqatave ankuese, se fëmijët romë dhe fëmijët egjiptianë keqtrajtohen dhe nuk pranohen në Qendër, Komisioneri konstaton se pranë tij nuk janë përcjellë prova dhe fakte konkrete, që dëshmojnë për ngjarje të tilla. Subjektet kundër së cilave drejtohet ankesa e mohojnë që ngjarje të tilla të kenë ndodhur dhe Organizata Shqiptare të Urdhërit të Maltës ka shprehur gadishmërinë e saj për ndjekjen e rasteve konkrete, që do të denoncohen pranë saj dhe marrjen e masave përkatëse ndaj punonjësve të Qendrës, që mund të kenë kryer veprime të tilla.

Në këtë kontekst, Komisioneri rekomandon, që nëse shoqatat ankuese disponojnë prova dhe fakte konkrete mbi raste dhune apo mospranimi në Qendër të fëmijëve romë e egjiptianë, t'i denoncojnë këto raste, si dhe punonjësit që kanë kryer veprime të dhunshme ndaj fëmijëve romë dhe egjiptianë në këtë Qendër, pranë Bashkisë Lezhë dhe Organizatës Shqiptare të Urdhërit të Maltës, si dhe në organet publike përkatëse.

Për sa më sipër, në përfundim të analizimit të të gjitha pretendimeve të shoqatave ankuese, sikurse edhe informacionit dhe provave e fakteve përkatëse të depozituara nga ana e Bashkisë Lezhë dhe Organizatës Shqiptare të Urdhërit të Maltës, Komisioneri gjykon se në kuptim të nenit 7, pika 1, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, dy shoqatat ankuese, përkatësisht Shoqata e Pavarur Mikse “Shpresë për të varfërit” dhe Shoqatës “Integrimi i Romëve të Veriut”, Lezhë, sikurse edhe fëmijët dhe përfaqësuesit e komunitet rom dhe atij egjiptian të qytetit të Lezhës, që frekuentojnë Qendrën Komunitare Multifunkionale Malteser Lezhë, nuk janë ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë, disfavorizues e të pabarabartë. Në mungesë të një trajtimi të tillë, nuk ekziston diskriminim, për shkaqet e pretenduara në ankesë.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenin 1, nenin 7, pika 1, nenin 20, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pika 4, gërma dh), si dhe pikat 10-11, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të komunitetit rom dhe komunitetit egjiptian, të qytetit të Lezhës, për shkaqet e pretenduara në ankesë, nga ana Bashkisë Lezhë dhe Organizatës Shqiptare të Urdhërit të Maltës.
2. Konstatimin e mosdiskriminimit, të Shoqatës së Pavarur Mikse “Shpresë për të varfërit” dhe Shoqatës “Integrimi i Romëve të Veriut”, Lezhë, për shkaqet e pretenduara në ankesë, nga ana Bashkisë Lezhë dhe Organizatës Shqiptare të Urdhërit të Maltës.
3. Rekomandohet që, nëse ekzistojnë raste konkrete dhune të fëmijëve romë dhe egjiptianë apo raste të refuzimit të tyre, për të patur akses në Qendrën Komunitare Multifunkionale Malteser, Shoqata “Integrimi i Romëve të Veriut”, e pajisur me akt përfaqësimi, të kryejë denoncimet përkatëse pranë organeve kompetente, si dhe pranë Bashkisë Lezhë dhe Organizatës Shqiptare të Urdhërit të Maltës.

4. Rekomandohet që, Bashkia Lezhë dhe Organizata Shqiptare e Urdhërit të Maltës, të përfshijnë në proçese informuese, lidhur me aktivitetet e takimet vendimarrëse, që kryhen në kuadër të mirë funksionimit të Qendrës Komunitare Multifunkionale Malteser, edhe shoqatat rome dhe ato egjiptiane të qytetit të Lezhës, që shprehin interes në këtë aspekt.
5. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim, brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Robert GAJDA**

---

**KOMISIONERI**

Fusha – te mira dhe sherbime  
Shkak –etnia, gjendja ekonomike, gjendja arsimore